



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
NDËRMARRJA RRUGA DURRES

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “**Rikonstruktion Bypassit ne kanalin kryesor vadites te Rezervuarit te Tarinit**”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247270-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 10.091.914 (dhjetë milion e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

Argumentimi i fondit limit: Fondi limit është përlogaritur nga grupi i punës i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe është vënë në dispozicion me anë të dokumentacionit teknik përkatës, i cili përfshin projektin/detyrën teknike, preventivin, specifikimet teknike, relacionin teknik dhe grafikun e punimeve për objektin në fjalë. Gjatë përlogaritjes së fondit limit janë mbajtur në konsideratë Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe neni 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Me qëllim që fondi limit të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe të mos abuzohet në përlogaritjen e tij, për zërat e punimeve në ndërtim është mbajtur në konsideratë manuali zyrtar i çmimeve të ndërtimit dhe VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, sipas së cilës institucionet shtetërore, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuara në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit.

Bazuar në manualin e sipërcituar, në preventivin dhe në dokumentacionin teknik të objektit, fondi limit për këtë procedurë rezulton në vlerën **10 091 914 lekë pa TVSH**.

Më pas, në mbështetje të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, specialistët e fushës së njësishë së prokurimit kanë bërë analizën dhe zbërthimin e preventivit dhe

të kriterëve të përcaktuara në DST, duke hartuar këtë procesverbal për argumentimin e kriterëve për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, si dhe në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Këto kërkesa janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi dhe kanë shlyer detyrimet përkatëse sipas përcaktimeve ligjore.

Paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar, refuzimit për nënshkrimin e kontratës, mosparaqitjes së sigurimit të kontratës kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës, sipas dokumenteve të tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të LPP, si dhe në nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë verifikon përshtatshmërinë ligjore dhe profesionale të operatorit ekonomik për ushtrimin e veprimtarisë që lidhet me objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e përlllogaritur e kontratës. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa është vendosur bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në natyrën emergjente të punimeve, në afatin e zbatimit dhe në nevojën që operatori ekonomik të ketë aftësi financiare të mjaftueshme për mobilizimin e kantierit, furnizimin me materiale, vendosjen në dispozicion të makinerive dhe realizimin e punimeve pa vonesa. Kriteri mbështetet në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe në nenin 43 të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Vlera e xhiros është në përpjesëtim me fondin limit dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet ekonomike të operatorëve ekonomikë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke mbajtur në konsideratë legjislacionin tatimor dhe atë të kontabilitetit, përfshirë Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe aktet nënligjore në fuqi për deklarimin dhe administrimin e të dhënave financiare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve 2023, 2024, 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, bilanci duhet të shoqërohen edhe me raport auditimi ligjor të

pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa është vendosur për të provuar stabilitetin financiar dhe gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik. Punimet e emergjencës mbi shkarjet në kanalin kryesor vaditës kërkojnë aftësi për të përballuar shpenzime paraprake, organizim të kantierit, risk teknik, mobilizim mjetesh dhe punonjësish, si dhe menaxhim financiar të qëndrueshëm përgjatë afatit të kontratës. Paraqitja e bilanceve dhe, kur është rasti, e raportit të auditimit, i jep Autoritetit Kontraktor mundësinë të verifikojë që operatori ka stabilitet financiar dhe nuk paraqet rrezik të shtuar për mosrealizim të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin e fundit, duke përfshirë edhe këstet e maturuara për vitin 2026, për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i BOE duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga njësitë administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3 të LPP, nenin 43 dhe nenin 41, pika 5/c, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Duke qenë se operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet, paraqitja e vërtetimit provon respektimin e detyrimeve ligjore vendore dhe shmang pjesëmarrjen e operatorëve me detyrime të pashlyera.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat minimale të përcaktuara në DST, si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose
- Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Në rastin e BOE zbatohen përcaktimet e DST lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes dhe ndarjen e punimeve ndërmjet anëtarëve.

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të LPP dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Me këtë kriter kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojë konkrete dhe të suksesshme në punime të ngjashme me objektin e prokurimit. Natyra e objektit, që lidhet me ndërhyrje emergjente mbi shkarjet në kanal vaditës, përfshin punime gërmimi, stabilizimi, vepra hidroteknike/vaditjeje, transport materialesh, punime betoni dhe masa për mbrojtje mjedisore. Për këtë arsye, përvoja e mëparshme është esenciale për të garantuar zbatim sipas standardeve teknike, cilësi, siguri dhe respektim të afateve.

Për kontratat e realizuara me sektorin publik ose privat, dokumentacioni provues i kërkuar në DST (formular vlerësimi, kontratë sipërmarrje, situacion përfundimtar, akt kolaudimi, certifikatë marrjeje në dorëzim dhe/ose fatura tatimore të deklaruara) është i nevojshëm për të verifikuar vlerën, natyrën, cilësinë dhe përfundimin me sukses të kontratave të ngjashme.

Kriteret teknike nga pika 2.3.2 e në vijim janë vendosur duke iu referuar natyrës së punimeve, preventivit, grafikut, specifikimeve teknike, nenit 74 dhe nenit 78 të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, si dhe praktikës së APP për hartimin e kriterëve të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik.

2.3.2 Licenca profesionale për zbatimin e punimeve objekt kontrate:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Niveli	Përshkrimi
NP-1	A	Punime gërmimi në tokë
NP-4	A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
NP-5	A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
NP-7	A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje
NP-12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-18	A	Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar bazuar në nenin 77 të LPP dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar. Kategoritë e licencës lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe natyrën e punimeve: gërmime dhe lëvizje dherash, ndërhyrje në vepra hidroteknike/vaditje, punime betoni dhe mbrojtjeje, punime topografike për piketim dhe kontroll kuotash, si dhe masa mjedisore për administrimin e materialeve dhe ndikimeve gjatë zbatimit. Në rast BOE, secili anëtar duhet të disponojë licencat sipas zërave që merr përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.

2.3.3 Personeli drejtues teknik dhe personeli mbështetës:

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

Nr.	Profili	Sasia
1	Inxhinier hidroteknik	1 (një)
2	Inxhinier gjeodet	1 (një)
3	Inxhinier mjedisi	1 (një)
4	Inxhinier gjeoteknik	1 (një)

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të disponojë në listëpagesat e tre muajve të fundit edhe personelin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/certifikatë përkatëse, konkretisht:

Nr.	Profili	Sasia
1	Inxhinier ndërtimi konstruktor	1 (një)
2	Inxhinier ndërtimi, profili infrastrukturë transporti	1 (një)
3	Punonjës specialist i trajnuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”	1 (një)
4	Punonjës specialist i trajnuar si “Ekspert në dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave”	1 (një)

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 4 të LPP dhe nenin 39, pika 6/c të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Profili i inxhinierit hidroteknik është i domosdoshëm për ndërhyrjet në kanal vaditës dhe funksionimin hidraulik të veprës; inxhinieri gjeodet për piketim, matje, kontroll kuotash dhe verifikim të gjeometrisë së kanalit; inxhinieri mjedisi për menaxhimin e ndikimeve mjedisore, mbetjeve, ujërave dhe materialeve gjatë punimeve; inxhinieri gjeoteknik për vlerësimin dhe trajtimin e shkarjeve, stabilitetit të shpateve dhe kushteve të terrenit. Inxhinieri konstruktor dhe inxhinieri i infrastrukturës së transportit lidhen me zbatimin

e elementeve konstruktive, ndërhyrjet në trupin e kanalit, akseset dhe elementet mbështetëse. Specialistët e sigurisë dhe të ndihmës së parë janë të nevojshëm për shkak të natyrës emergjente të punimeve, përdorimit të makinerive të rënda dhe risqeve në kantier, në përputhje me Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.4 Punonjës të specializuar/të kualifikuar:

Kategoria	Profili	Sasia
Staf teknik	Teknik ndërtimi	1 (një)
Staf teknik	Betonues	3 (tre)
Staf teknik	Karpentier	4 (katër)
Staf teknik	Punëtorë ndërtimi të thjeshtë	10 (dhjetë)
Manovratorë	Eskavatorist	2 (dy)
Manovratorë	Shofer	2 (dy)

Për stafin teknik dhe punonjësit e specializuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë profesionale/certifikatë ose dokument tjetër që provon kualifikimin profesional, si dhe certifikatë sigurimi teknik kur kërkohet sipas profilit të punës. Për shoferët dhe manovratorët duhet të paraqiten dokumentet përkatëse sipas përcaktimeve të DST, përfshirë leje drejtimi, certifikatë aftësie profesionale ose dëshmi aftësie profesionale për përdorimin e makinerive të rënda.

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të LPP dhe nenin 39, pika 6/c dhe 6/ç, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Numri dhe profili i punonjësve është vendosur në përputhje me zërat e preventivit, nevojën për punime betoni, vendosje betonformash, gërmime, transport, përpunim dhe vendosje materiale, si dhe me afatin 180 ditë kalendarike për zbatimin e kontratës. Kërkesa i shërben garantimit që operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të nevojshme për organizim të pandërprerë të kantierit dhe për kryerjen e punimeve sipas standardeve teknike e të sigurisë.

2.3.5 Fuqia punëtore minimale:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 30 punonjësish në listëpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 4, të LPP dhe nenin 39, pika 6/c, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Duke qenë se objekti përfshin punime emergjente në kanal vaditës dhe kërkon mobilizim të menjëhershëm të stafit, kërkesa për 30 punonjës është proporcionale me volumin e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, nevojën për disa fronte pune, përdorimin e makinerive, punimet e betonit dhe masat e sigurisë në kantier. Ky kriter garanton që operatori ekonomik nuk mbështetet vetëm në kapacitete të rastësishme, por disponon strukturë të qëndrueshme punonjësish për realizimin e objektit.

2.3.6 Mjetet dhe pajisjet teknike:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive/pajisjeve	Pronësia	Sasia
1	Eskavator me zinxhir	Pronësi ose me qira	2 copë
2	Minieskavator me zinxhir gome, min. 5 ton deri në 6.5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
3	Rrul me vibrim për rrugë	Pronësi ose me qira	1 copë
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri në 18 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
5	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 18 ton	Pronësi ose me qira	1 copë

6	Kamionçinë me kapacitet min. 5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
7	Motogjenerator	Pronësi ose me qira	1 copë
8	Motorpompë uji	Pronësi ose me qira	1 copë
9	Tokmak	Pronësi ose me qira	1 copë
10	Betoniere	Pronësi ose me qira	3 copë
11	Matrapikë	Pronësi ose me qira	4 copë
12	Vibrator betoni	Pronësi ose me qira	3 copë
13	Betonforma	Pronësi ose me qira	1000 m²
14	Zyrë kantieri	Pronësi ose me qira	1 copë
15	Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	Pronësi ose me qira	1 copë

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike, operatori duhet të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar në DST për mjetet në pronësi ose me qira, përfshirë leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik, siguracion, certifikatë transporti mallrash brenda vendit kur aplikohet, aktet e pronësisë/zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kontratat noteriale të qirasë me afat dhe objekt të përcaktuar.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 4, të LPP dhe nenin 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Me këtë kriter kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë se ka në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Lloji dhe numri i mjeteve janë vendosur në përpjesëtim me natyrën emergjente të ndërhyrjes, volumin e punimeve, gërmimet, transportin e materialeve, kompaktimin, punimet e betonit, largimin/menaxhimin e ujërave, organizimin e kantierit dhe nevojën për mobilizim të menjëhershëm. Pajisjet e kërkuara lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me grafikun e punimeve, duke i shërbyer Autoritetit Kontraktor për të vlerësuar aftësinë reale të operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Certifikatat e menaxhimit:

Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikata të vlefshme ose ekuivalente si më poshtë:

Nr.	Certifikata/standardi	Qëllimi i lidhjes me objektin
1	ISO 9001:2015 - Sistemi i menaxhimit të cilësisë	Garanton organizim cilësor, kontroll procesesh dhe zbatim sipas standardeve të pranuar.
2	ISO 45001:2018 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë	Garanton menaxhimin e risqeve të sigurisë në kantier, veçanërisht për punime me makineri të rënda dhe punime emergjente.
3	ISO 14001:2015 - Sistemi i menaxhimit të mjedisit	Garanton menaxhimin e ndikimeve mjedisore gjatë punimeve, materialeve, dherave dhe ujërave.
4	ISO 39001:2012 - Sistemi i menaxhimit për sigurinë në trafikun rrugor	Lidhet me përdorimin e mjeteve të transportit, lëvizjen e kamionëve dhe sigurinë gjatë aksesit në kantier.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë dhe certifikimit janë vendosur në mbështetje të nenit 79, pika 1, të LPP dhe nenit 44, pika 1 dhe 3, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, sipas të cilave autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë certifikata të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kur ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 lidhet me menaxhimin e cilësisë dhe kontrollin e proceseve gjatë zbatimit të punimeve. ISO 14001:2015 lidhet me menaxhimin e ndikimeve mjedisore gjatë gërmimeve, transportit, administrimit të

materialeve dhe mbrojtjes së zonës përreth kanalit. ISO 45001:2018 lidhet me menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke ulur riskun e aksidenteve në kantier. ISO 39001:2012 lidhet me sigurinë e trafikut rrugor dhe lëvizjen e mjeteve të rënda drejt/nga kantieri, duke qenë se procedura kërkon kamionë, rimorkiator dhe mjete transporti. Të gjitha certifikatat pranohen edhe në formë ekuivalente, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë.

2.4.2 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor të parashikuar në grafikun e miratuar për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me organizimin e zbatimit të kontratës dhe me afatin 90 ditë kalendarike të parashikuar në DST. Grafiku i punimeve i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë nëse operatori ekonomik ka planifikuar në mënyrë realiste fazat e mobilizimit, punimet paraprake, gërmimet, stabilizimet, punimet e betonit, vendosjen e betonformave, transportin e materialeve, kontrollin teknik dhe dorëzimin e objektit. Kjo kërkesë garanton që oferta të jetë e shoqëruar me plan pune të zbatueshëm dhe të lidhur me afatin kontraktor.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës/detyra teknike, raporti teknik, preventivi me zërat e punimeve dhe grafiku i punimeve janë pjesë e DST dhe shprehin qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e punimeve dhe materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera të lidhura ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të LPP, si dhe nenin 39, pika 2, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Ato synojnë të garantojnë që punimet të realizohen sipas standardeve teknike, cilësisë së kërkuar, sigurisë në kantier dhe kërkesave funksionale të objektit. Nëse në specifikime teknike ka referenca ndaj standardeve, materialeve, proceseve apo zgjidhjeve konkrete, ato duhet të lexohen të shoqëruara me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe parimin e mosdiskriminimit.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve lidhur me kapacitetet ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike për këtë objekt prokurimi është bërë në respektim të parimeve të proporcionalitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, duke marrë në konsideratë natyrën emergjente të punimeve, vlerën e fondit limit, afatin e zbatimit, nevojën për kapacitete të specializuara dhe dokumentacionin teknik të përfshirë në DST.